



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit komunal e mbajtur me dt.02.08.2024, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari, (IQO) Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Lendita Krasniqi. (LVV), Valon Svirca (LVV), Albana Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK) dhe Ratomir Ristic (SL).

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, përf. e kompanisë "INSI" përf. e KFOR-it, përf. e OSBE-së dhe qytetarët

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

## R E N D D I T E

1. Hapja e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor - Harta zonale e Komunës së Obiliqit 2024 – 2032

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 17 vota për.

Pastaj, kryesuesja paraqiti kërkesën e Drejtorisë për planifikim urban pronë dhe kadastër për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme si dhe Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për miratimin e vendimit lidhur me hapjen e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor – Harta zonale e Komunës së Obiliqit 2024 -2032. Për një prezentim të shkurtër të Draft dokumentit në fjalë fjalën ia dha drejtorit të DPUKP-së.

**Arben Berisha** – Të nderuar anëtarë të Kuvendit dhe të tjerët të pranishëm, fjala është për një dokument jetik të Komunës së Obiliqit, për të cilin dokument kemi punuar bashkarisht me qytetarët nëpër lokalitete të ndryshme duke i marrë për bazë edhe kërkesat e tyre. Ne kemi qenë me njerëz gjatë gjithë kohës për mbështetjen e Kryetarit që kemi pasë si në takimet me qytetarët, ashtu edhe në takimet e mbajtura jashtë Komunës. Gjithashtu, jemi edhe me ekspertët e Komunës tonë, një Komision jashtëzakonisht të përgatitur

që si rezultat i tyre kemi ardhë deri në pikën për ta pasur një Komunë të zhvilluar me të gjitha potencialet si ekonomike dhe të gjitha pikëpamjet që ne kemi me i pasë. E falenderojmë edhe kompaninë Insi një kompani jashtëzakonisht e përgatitur që me përkrahjen dhe mbështetjen e tyre kemi ardhë deri te finalizimi i këtij dokumenti. Unë e ftoj kompaninë që ta bëjë prezentimin në pika të shkurtëra sepse prezentimin detaj do ta bëjmë në fund pas 30 dite, kur do të kërkojmë nga ju që të votoni.

**Armend Sokoli**, përfaqësues i kompanisë “INSI” – Baza ligjore e këtij dokumenti është me reformën ligjore të bërë në vitin 2013 është bërë hartimi i Ligjit për planifikim hapësinor L-174, ku përmes këtij ligji obligohen të gjitha Komunitet e Republikës së Kosovës, që ta hartojnë këtë dokument i cili vjen pas hartimit të Planit zhvillimor, që Komunitet e Obiliqit në vitin e kaluar veç e ka aprovuar. Obligim i këtij ligji është edhe që të bëhet pjesëmarrje publike, do të thotë ky dokument të prezentohet edhe para qytetarëve duke u bazuar në këtë Udhëzim administrativ për përgjegjësitë dhe autoritetet e planifikimit hapësinor. Gjatë këtij procesi kemi pasë me dhjetëra prezente dhe diskutime të qytetarëve, ku janë marrë të gjitha kërkesat, komentet dhe sugjerimet e tyre, ku disa janë harmonizue me këtë dokument të planifikimit hapësinor. Ky dokument është dashur që ti plotësoj edhe direktivat evropiane për të dal në shqyrtimin publik, deri në këtë fazë ku jemi. Po ashtu, ky dokument bazohet edhe në planet e nivelit qëndror që e kemi Planin hapësinor të Kosovës të hartuar për periudhën 2010-2020 si dhe në Planin hapësinor për zonën e veçantë që e kemi në Obiliq, zonën e veçantë të fushës së mihjes. I gjithë territori i Komunës së Obiliqit ndahet në zona, duke u bazuar në hartën e shfrytëzimit të tokës që është e planifikuar me Planin e zhvillimit komunal, ato zona merren dhe ndahen duke u bazuar në normat teknike, ju jepen kode se për çfarë duhet të shfrytëzohen ato zona. Këto zona do të kenë nevojë edhe për infrastrukturë teknike si ujësjellësi, kanalizimi e tjera, do të thotë janë kushtet teknike se sa ka nevojë të shtohen ato kushte teknike. Është pjesa e infrastrukturës rrugore se si do të zhvillohen rrugët, në çfarë kushte do të zhvillohen, pastaj është infrastruktura sociale dhe publike që parashehë se sa ka nevojë për çerdhe, shkolla se ku i ka paraparë plani zhvillimor komunal. Kjo, i jepë kushte se si do të ndërtohen ato dhe sa do të jenë specifikat dhe kushtet ndërtimore të tyre. Harta zonale përveç pjesës tekstuale ka edhe pjesën e saj hartografike, që është harta e shfrytëzimit të tokës që rrjedhë nga Plani zhvillimor komunal dhe këtu është bërë kodifikimi si dhe ndarja e zonave. Në këtë hartë do ti kemi të gjitha kodet dhe shembull nëse e shohim ZSH 3, apo ZB 4 kushtet që janë brenda saj te ZB 4 në pjesët tekstuale vlejne për këtë zonë, apo për atë zonë tjetër. Sistemi gjeografik i informacionit GIS bën ndërlidhjen e pjesës hartografike deri në nivel të parcelës, do të thotë për secilën pjesë të territorit të Komunës së Obiliqit mund të dijmë deri në nivel të parcelës se çka planifikohet dhe cilat do të jenë kushtet për zhvillim të kësaj pjese.

**Shaip Paloja** – Mua, drejtor më intereson pjesa me interes nacional, ku është zona e KEK-ut, a mundesh pak a shumë me na shpjegue formën e zhvillimit të asaj zone, si do të ndodhë dhe si do të pajisen banorët me leje ndërtimi në atë pjesë.

**Arben Berisha** – Përgjegjet këtu, e kemi zonë të përkohshme, ndërtime të përkohshme me ndërtime të lehta dhe zhvillimet e KEK-ut, që do të ndodhin në këtë pjesën këndeje. Në momentin që vjen deri te shpronësimi e keni të drejtën e ndërtimit të një ndërtimi të vogël, jo ndërtime të larta por ndërtime të përkohshme për arsye të shtrirjes së KEK-ut, sepse ne i kemi edhe hartat e KEK-ut se nga do të shtrihet. Mirëpo, iu kemi krijuar mundësinë që deri më tash nuk e kanë pasë atë mundësi që nëse, ka nevojë për zgjerim të familjes me pasë atë mundësi zgjerimi si dhe një mundësi të investimit të vogël, e jo investime të larta.

**Bajram Hashani** - Këtu, u përmend ndërtimi i përkohshëm nga drejtori nëse, mundesh pak drejtor me na sqarue ndërtimin e përkohshëm.

**Arben Berisha** – Sqaron nëse, shtrirja e mihjeve ndodhë brenda 10 vjeçarit, ne nuk mund të lejojmë ndërtime të larta, ose ndërtime të përhershme për arsye se shtrirja e KEK-ut, do të jetë aty dhe investimet do të shkojnë në humbje. Për mos me krijuë humbje te qytetarët, ne kemi mendue që ndërtimi të jetë i përkohshëm për zgjerim familjar edhe 10 m<sup>2</sup> të shtëpisë ka mundësi me u zgjerue.

**Valon Svirca** – Drejtor e kuptova pak, por edhe një herë me na sqarue pasi janë edhe qytetarët këtu, për pjesën prej sheshit “Adem Preniqi” deri lartë a lejohet ndërtimi dhe sa ka me qenë.

**Arben Berisha** – Sqaron kjo, është rruga “Ferid Curri” dhe ky është sheshi “Adem Preniqi” tash mbi sheshin “Adem Preniqi” deri në kodër lartë atje, do të thotë jemi Komunë që e kemi marrë koeficientin duke u bazuar në Ligjin për Obiliqin sepse në bazë të numrit të banorëve kishte me qenë problem me marrë. Mirëpo, jemi Komunë specifike dhe paraqitja jonë para Ministrisë, ka qenë që me dallue Obiliqin, për arsye të problematikave që i kemi.

**Enver Gashi** - Unë vetëm po e plotësoj pyetjen e kolegut se Millosheva qysh është edhe Mazgiti, brezi rreth magjistrales për me ngjyrë po e shohim se ka ndërtim edhe aty.

**Arben Berisha** – Te hyrja e Obiliqit, e kemi mendue edhe me plan zhvillimor se do të ketë zhvillim të biznesit, e jo ndërtimeve dhe aty do të ketë vetëm një zgjerim më të mirë që kemi mbërri me Ministrinë me zgjerue. Edhe është krijuar një korridor komplet i zhvillimit deri në Milloshevë, që është edhe rrethi i llapit deri te Baimoci, që edhe kjo të jetë për zhvillimin e bizneseve. Këtë tjetrën të Milloshevës, e kemi lënë për ndërtime të vogla 8 + 4 por do të jetë një qendër shumë e zhvilluar dhe e banimit. Ne e kemi dallue me qëllim sepse vlera e tokës në Milloshevë është shumë e madhe. Prej rrethit të hyrjes në Milloshevë deri te rrethi i daljes komplet Milloshevën e kemi lënë që të jetë ndërtim për arsye se kemi ndërtime të banimit në këtë pjesë.

**Kryesuesja** – Para se shkojmë me votim fjalën ia japë Kryetarit të Komunës.

**Kryetari i Komunës** – Singerisht pas një pune jashtëzakonisht të madhe dhe pas Planit zhvillimor me hartën zonale pritet që brenda një afati shumë të shkurtë të kompletohet në tërësi. Unë e falenderoj komplet ekipin punues i cili ka qenë i angazhuar në realizimin e këtij projekti, i falenderoj të gjithë qytetarët që kanë qenë pjesë e debateve, normalisht Asamblenë patjetër që ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, kompaninë INSI që kanë gjithmonë të gatshëm edhe pse kanë ndodhë plotësim ndryshime, gjatë punimeve, kanë qenë shumë korrekt në aspektin në punë. Patjetër, e falenderojmë edhe Ministrinë për angazhimin që sa më shpejtë të jetë Drafti në Kuvend, që të krijohet mundësia për debat publik.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 17 vota për e aprovuan Vendimin për Hapjen e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor - Harta zonale e Komunës së Obiliqit 2024 – 2032.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45’

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi

